



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0275**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NTSH AR-DRITI kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit:616-26-258-5-2-1, me 21/05/2026, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE NTSH AR-DRITI me nr. 2026/0275, e datës 27/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit: 616-26-258-5-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1 **te kthehet në rivlerësim.**
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik NTSH AR-DRITI

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29/01/2026, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit: 616-26-258-5-2-1.

Me 14/04/2026, OE NTSH AR-DRITI ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27/04/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE NTSH AR-DRITI me nr. 0275/2026 lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit: 616-26-258-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NTSH AR-DRITI janë parashtruar si në vijim:**

Pas njoftimit për dhënie të kontratës më 07.04.2026, konform Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, kemi bërë kërkesë pranë AK-Komuna e Prishtinës, e cila na ka lejuar qasje dhe ka qenë shumë korrekte gjatë procedurës.

Pas analizës detale nga ekspertët e prokurimit nga kompania jonë, kemi gjetur shumë mangësi në vlerësimin e ofertës nga ana e komisionit. Sipas analizës sonë, rezulton që grupi OE DachGroup SH.P.K & Papi.S Construction SH.P.K është ofertë e papërgjegjshme konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Në këndvështrimin tonë, nuk është i pranueshëm vendimi nga AK-ja, në raport me përmbajtjen e dokumenteve të dorëzuara nga GOE i propozuar për dhënie të kontratës, ndaj si e tillë, ne kemi ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, dhe pas të gjithë prezantimit të fakteve, AK-ja ka refuzuar kërkesën tonë.

Sipas kërkesave të dosjes, pika 8.1 dhe 8.2:

1. Operatori ekonomik duhet t’i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale, ka qenë jo më pak se 250,000.00 Euro (60% bartësi i konzorciumit).
2. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo konfirmimi nga banka për qarkullimin e kërkuar.

Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.

Pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë). (60% bartësi i konzorciumit).

2. Dëshmia – Një listë e kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, ku duhet të saktësohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit, si dhe përfituesi, dhe listës t’i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Prezantojmë faktet:

Gjatë analizimit të kontratave të ofruara në Aneksin 6, kemi gjetur si në vijim:

1. “Ndërtimi i parkut afër objektit të Komunës së Mitrovicës Veriore në rrugën Çlirimi”, nuk gjendet në listën e projekteve të paraqitura nga OE dhe raporti teknik i kësaj kontrate është i përkohshëm dhe nuk i përmbush kërkesat nga AK.
2. “Ndërtimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë”, nuk ka pranim teknik të nënshkruar nga komisioni dhe OE nuk është lider i kësaj kontrate. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.
3. Pika 1 në listën e projekteve: “Renovimi i shkollave fillore të mesme të ulëta në Fushë Kosovë dhe fshatra”. Ky projekt është në listën e projekteve, por nuk është paraqitur kontrata dhe vetëm një referencë. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.
4. Sipas listës së projekteve nga OE, pika nr. 2: “Renovimi i rrethojave të SHFMU ‘Laura Skoti’ në fshatin Grabovc i Poshtëm dhe SHFMU ‘Vëllezërit Frashëri’ në Miradi e Epërme”, nuk e ka prezantuar kontratën, vetëm një raport teknik. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.
5. Pika 3 në listën e projekteve: “Renovimi i hapësirave të spitalit (Lot 2 – Renovimi i objekteve të administratës)”. Ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një raport të pranimit teknik. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.
6. Pika 4 në listën e projekteve: “Rikonstruktimi i hapësirës publike në rrugën Egnatia, lagjja Ulpiana”. Ky projekt është në listën e projekteve, por nuk e ka paraqitur kontratën dhe vetëm një certifikatë të pranimit të përkohshëm. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.

Të gjitha projektet e paraqitura nga OE në listën e projekteve – Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur dosjen e tenderit dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK-ja, pasi që në të gjitha projektet e paraqitura OE nuk është lider në asnjë projekt, sipas kërkesës në FTD, ku lideri është dashur të përmbushë së paku 60% të vlerës.

5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.
6. Një listë e pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim me qira.
7. Te kjo kërkesë kemi gjetur se grupi OE DachGroup SH.P.K & Papi.S Construction SH.P.K ka dështuar në listën e pajisjeve të kërkuara:

Një ekskavator deri në 5.5t – ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Albi Trans 2023 L SH.P.K, ku ka prezantuar faturën me nr. 25-SHV01-001-5 dhe DUD-in doganor, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.

Një ekskavator deri në 5.5t – ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Burimi E SH.P.K, ku ka prezantuar faturën me nr. 15/2022 nga MANI SH.P.K dhe faturën me nr. 20/2024 nga FATMIR X BOSHNJAKU B.I dhe DUD-at doganorë, por nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.

Një ekskavator deri në 5.5t – ka prezantuar një marrëveshje huazimi me Varna SH.P.K, ku ka prezantuar kontratën për shitblerje dhe DUD-in doganor, por nuk ka paraqitur faturën dhe dëshminë e pagesës bankare. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK.

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9, 12, 13).
5. Një listë e pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim me qira.

Te kjo kërkesë kemi gjetur se grupi OE DachGroup SH.P.K & Papi.S Construction SH.P.K nuk i ka përmbushur kriteret në dosjen e tenderit.

Sipas dëshmive të paraqitura nga OE, certifikata nga DOQANLED nuk i plotëson kërkesat e paraqitura nga AK, pasi që ne konsiderojmë se ky dokument është jo valid dhe përmban shënime shumë të pakta dhe jo konkrete.

Ndërsa në autorizimin e EURO ON GROUP SH.P.K të paraqitur, nuk janë të cekura në autorizim pikat 12 dhe 13. Ne konsiderojmë se OE nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë nga AK, pasi që në FTD është kërkuar që autorizimi të jetë valid për pozicionet e caktuara.

Ndërsa për autorizimin nga prodhuesi Yucel Bahce, kërkojmë që të verifikohet nga prodhuesi nëse ky autorizim është valid, pasi ka mundësi që të bëhen manipulime në mënyrë digjitale të nënshkrimit, pasi në autorizim nuk ka asnjë informatë mbi të dhënat e biznesit, ku duhet të ketë ndonjë informatë mbi kontaktin e autorizuesit, e që në këtë rast mungojnë, dhe si të tillë e konsiderojmë të nevojshme dhe të obligueshme që të bëhet verifikimi në mënyrë që të validohet autorizimi, përndryshe ky autorizim konsiderohet i pavlefshëm.

Këto fakte të prezantuara janë mjaftueshëm të evidentueshme që të konkludohet se ky grup OE është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat në FTD dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me fushëveprimin e LPP-së.

Në bazë të sqarimeve dhe fakteve të prezantuara më lartë, kërkohet që të aprovohet kërkesa jonë duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura, shkresat e lëndës, analizën konkrete dhe dokumentacionin e lëndës, si dhe provat që ju kemi ngarkuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim, pasi që ne jemi kompania që i plotësojmë të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK.

Fillimisht, vendimin për eliminim si Letër Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm e kundërshtojmë në tërësi dhe pretendojmë se AK në arsyetimin e vet ka vepruar në kundërshtim të plotë me vlerësimin e tenderit, duke mos i respektuar kushtet për kualifikim dhe përzgjedhje të OE.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30/04/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0275/2026, ndërsa me datë 14/05/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0275/2026, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

### **Lidhur me pretendimet e OE NTSH AR-DRITI eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0275 ka vlerësuar si në vijim:**

Pretendimi nr.1

Sipas ankesës 275/26 pretendimet e para ankimore janë kundrejt OE të rekomanduara për kontratë, ku i njëjti pretendon se për një numër të kontratave, OE në fjalë nuk ka qenë lider i grupit, për kontratë tjetër është ofruar vetëm raport për pranim të pjesshëm, dhe se për tri projekte është paraqitur vetëm referenca mirëpo jo edhe kontrata.

AK në vendim për rishqyrtim është përgjigjur se të njëjtin kanë kërkuar sqarime shtesë, ku pas sqarimeve AK ka konstatuar se OE i plotëson kërkesat.

Pas analizimit të sqarimeve të ngarkuara në E-Prokurim, ne kemi gjetur se AK ka kërkuar sqarime lidhur katalogun e prodhuesit mirëpo jo edhe për kontratat e kontestuara nga OE ankues.

Me qenë se në dosje të tenderit është kërkuar decidivisht “OE ka përfunduar me sukses kontrata” dhe te dëshmia dokumentare është kërkuar “një listë e kontratave të realizuara”. Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, dhe rekomandon që me rastin e rivlerësimit AK të kërkojë informata shtesë dhe të pranohen vetëm projektet/kontratat e përfunduara (realizuara në tërësi), po ashtu të kërkojë sqarim për kontratat ku OE ka qenë anëtar i grupit të sqarohet se sa ka qenë pjesëmarrja/kontributi i OE në fjalë për atë projekt dhe vlera e referencës të llogaritët sipas pjesëmarrjes. Po ashtu të kërkojë plotësim i dokumenteve në pajtim me LPP për projektet për të cilat nuk është ofruar kontratë fare.

Pretendimi nr.2.

Lidhur me pretendimet ankimore sa i përket pajisjeve, për një numër të pajisjeve OE ankues pretendon se *nuk ka paraqitur dëshminë e pagesës bankare- Ne konsiderojme se OE nuk i ka permbushur kete pike dhe eshte i pergjegjshem ne permbushje e kesaj kerkese nga AK.*”

Eksperti shqyrtues vlerëson se një gjë t tillë nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, askund në dosje nu kërkohet të dëshmohet pajisja përmes pagesës bankare.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimore është i pabazuar.

Pretendimi nr.3

Sa I përket pretendimeve lidhur me katalogun e prodhuesit, AK pas kërkesës për sqarime ka pranuar sqarimet e OE, duke bashkangjitur deklarata nga distributori i autorizuar dhe prodhuesi, pas të cilave AK ka vlerësuar se plotësohen kërkesat e dosjes.

Të njëjtin mendim ndajmë edhe ne në cilësi të ekspertit shqyrtues, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimore nuk është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues për manipulim apo falsifikim të dokumenteve , eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi autorizim/kompetencë e as kapacitet profesional për tu përgjigjur në pretendim të tillë ankimore dhe OE ankues mund të i drejtohet organeve tjera kompetente.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ju fal besimin e plotë, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me numër të prokurimit 616-26-258-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim. Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimore sa i përket falsifikimit secila palë në procedurë por edhe AK konform nenit 52.7 të LPP mund të ju drejtohet organeve përgjegjëse, ngase, OSHP nuk ka as kapacitete teknike dhe as profesionale ta bëjë një verifikim të tillë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë

një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.T.SH. " AR - DRITI "**
- Arkivës së OSHP-së: